

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE
PËR ZBATIMIN E GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË
MBETJEVE PËR TË GJITHA RRYMAT E MBETJEVE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektvendimi synon të krijojë një kuadër ligjor të qartë, të detajuar dhe të zbatueshëm për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ky akt nënligjor hartohet në përputhje me autorizimin ligjor sipas pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Nëpërmjet këtij akti rregullator përcaktohen kriteret, procedurat dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese mbrojtjes ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, me qëllim reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohen, rritjen e nivelit të riciklimit dhe rikuperimit, si dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

Objektivi i këtij akti është sigurimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim, promovimi i ripërdorimit, riciklimit, parandalimi i përzierjes së mbetjeve, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TE TJERA POLITIKE**

Ky projektakt është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakeve (PPAP) të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026 dhe vjen në zbatim të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi “Për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve” përbën një ndërhyrje të domosdoshme ligjore që ofron një zgjidhje të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshme në sektorin e mbetjeve. Ai përfaqëson një hap të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave mjedisore të vendit dhe shërben si një instrument i nevojshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm, transparent dhe efikas për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në Shqipëri.

Autorizimi ligjor, konkretisht pika 2, e nenit 11, parashikon nxjerrjen e vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e kritereve, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve, dhe projektvendimi parashikon rregulla për mbetjet bashkiake, të cilat, referuar pikës 21, të nenit 3, të ligjit 57/2025, nënkuptojnë:

a) mbetje shtëpiake të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet, përfshirë të gjitha pjesët përbërëse të tyre individuale apo të bashkuara dhe materialet e konsumit, që janë pjesë përbërëse e këtyre pajisjeve, mbetjet e baterive, mbetjet e vëllimshme, duke përfshirë mobilet, dyshekët dhe të ngjashme;

b) mbetje të përziera dhe mbetje të grumbulluara në mënyrë të diferencuar nga burime të tjera, kur këto mbetje kanë natyrë dhe përbërje të ngjashme me mbetjet shtëpiake.

Pra, mbetjet përfshijnë edhe rrymat e tjera të mbetjeve, sic janë ambalazhet, mbetjet bio, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike etj., dhe rregullat e parashikuara do të shërbejnë si referencë në nxjerrjen e akteve specifike nënligjore në zbatim të kreut IV të ligjit, nëpërmjet të cilave do të detajohen rast pas rasti kriteret, procedurat dhe afatet për secilën rrymë mbetje sipas autorizimeve ligjore përkatëse të parashikuara në këtë kre.

Projektvendimi përbën gjithashtu një komponent thelbësor të përpjekjeve më të gjera për të përmirësuar dhe forcuar sigurinë mjedisore në vend, si dhe për të avancuar angazhimet e Shqipërisë në kuadër të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përfshirë këtu edhe direktivën 2008/98/KE “Për mbetjet”.

Zbatimi i dispozitave të këtij akti do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, në mbrojtjen e shëndetit e njeriut, duke garantuar parandalimin e përzierjes së mbetjeve, reduktimin e ndotjes mjedisore dhe rritjen e rikuperimit të materialeve. Në të njëjtën kohë, projektakti pritet të gjenerojë efekte pozitive ekonomike dhe sociale, duke optimizuar kostot dhe duke nxitur zhvillimin e sektorit të riciklimit, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e ndërgjegjësimit për ndarjen e mbetjeve në burim. Në këtë kontekst, projektakti përbën një instrument të rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve publike vendore dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Ky bashkëpunim është thelbësor për zbatimin e standardeve të reja dhe për arritjen e objektivave afatgjata në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 11 të Ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim është në harmonizim me kërkesat e ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe synon të përafrojë nenin 10, pika 2, nenin 11, pika 1, paragrafi 2 dhe nenin 11, pika 2, paragrafi 3 të direktivës 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është organizuar në 5 Krerë, të cilat parashikojnë dispozitat e përgjithshme, kriteret, procedurat, afatet për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe dispozitat e fundit, si më poshtë:

Kreu i parë përmban dispozita të përgjithshme për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve bashkiake, në përputhje me kuadrin kombëtar dhe atë evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në nenin 3, pika 21, të Ligji nr. 57/2025 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’.

Mbetjet bashkiake përfshijnë: letrën dhe kartonin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drurin, tekstilet, ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike (përfshirë përbërësit e tyre), bateritë dhe mbetjet e baterive, si edhe mbetjet e vëllimshme, si mobiliet, dyshekët dhe të ngjashme, si dhe mbetjet e përziera me mbetjet shtëpiake.

Kreu i dytë trajton kriteret për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga qytetarët, bizneset dhe institucionet që prodhojnë mbetje të cilët duhet të angazhohen direkt në ndarjen e tyre që në burim. Çdo individ ose njësi ekonomike duhet të vendosë mbetjet sipas llojit të materialit, në mënyrë që fraksionet e riciklueshme dhe ato jo të riciklueshme të mbeten të ndara.

Grumbullimi i diferencuar parandalohet përzjerjen e fraksioneve të ndryshme të mbetjeve, si letër, plastika, metale apo qelq në mënyrë të tillë që të rritet cilësia e ripërdorim, riciklim dhe trajtim të mëtejshëm. Mbledhja e ndarë në burim lejon krijimin e lëndëve të para dytësore me cilësi më të lartë, të cilat mund të përdoren në mënyrë efektive në industrinë e riciklimit.

Gjithashtu kreu përcakton edhe se grumbullimi i diferencuar duhet të kryhet me kontejnerë dhe pajisje të posaçme që janë të përshtatshme, të mbyllura ose të mbrojtura, rezistente ndaj dëmtimeve mekanike dhe kushteve atmosferike, të lehta për pastrim dhe dezinfektim. Ato duhet të jenë të identifikueshme me ngjyra specifike sipas standardeve evropiane dhe të kenë etiketa të dukshme, të lexueshme dhe rezistente që tregojnë qartë llojin e mbetjeve të depozituara.

Kreu i tretë trajton procedurat e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në të cilën përcaktohet se krijuesit dhe zotëruesit i mbetjeve duhet të ndajnë dhe të grumbullojnë mbetjet në mënyrë të diferencuar, sipas udhëzimeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe duke respektuar grafikun, frekuencën dhe mënyrën e grumbullimit. Mbetjet vendosen në zonat e shërbimit, pikat e përcaktuara ose në mënyra të tjera që përputhen me legjislacionin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Operatorët pa leje mjedisi tip B ose licencë III.2.b duhet të raportojnë çdo vit, deri më 15 shkurt, sasinë dhe llojet e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar pranë njëjësive vendore. Njësitë e vetëqeverisjes raportojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit deri më 28 shkurt mbi sasinë, llojin, frekuencën,

mënyrën e grumbullimit, kontraktorët e përfshirë, destinacionin, trajtimin, problematikat dhe masat për përmirësim.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit përpunon këto të dhëna dhe përgatit raportin vjetor mbi mbetjet për vitin e mëparshëm deri më 31 maj të çdo viti.

Kreu i katërt janë parashikuar afatet dhe masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për arritjen e objektivave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të paktën për grumbullimin e diferencuar të plastikës, drurit, metaleve me ngjyra, aluminit, qelqit, letrës dhe kartonit, të cilat lidhet kryesisht me rrymat e zakonshme të mbetjeve bashkiake, që janë në përgjithësi jo të rrezikshme dhe të përshtatshme për riciklim përmes proceseve mekanike standarde.

Afatet minimale për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklimin për këto rryma përcaktohen si më poshtë: të paktën 25% deri në vitin 2030, 50% deri në vitin 2033, 55% deri në vitin 2035, 60% deri në vitin 2040 dhe 65% deri në vitin 2045, duke bërë të mundur reduktimin e së sasinë së mbetjeve që përfundojnë në landfill dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e objektivave të ekonomisë qarkulluese, sipas kuadrit të përcaktuar nga Direktiva 2008/98/BE.

Pajisjet elektrike dhe elektronike si edhe mbetjet e baterive përbëjnë rryma mbetjesh me regjim të veçantë juridik, për shkak të përmbajtjes së substancave potencialisht të rrezikshme dhe kompleksitetit të përbërjes së tyre dhe kompleksitetit të përbërjes së tyre dhe miratimi i tyre bëhet me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave. Këto kategori kërkojnë trajtim të specializuar, sisteme të posaçme grumbullimi dhe përpunimi, si dhe zbatimin e parimit të përgjegjësive së zgjeruar të prodhuesit, në përputhje me Direktivën 2012/19/BE dhe Direktivën 2006/66/KE.

Kreu i pestë, parashikon dispozitat e fundit, ku është shfuqizuar vendimi nr. 418, datë 25.6.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” dhe janë përcaktuar institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a., njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga strukturat përgjegjëse në ministri dhe është konsultuar me ekspertët e GIZ, në kuadër të projektit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Rritjen e Gjelbër” .

Duke qenë se ky projektakt parashikon marrjen e masave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në funksion të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bashkiake, si dhe në zbatim edhe të autorizimit ligjor, është dërguar në rrugë elektronike, në datë 8.02.2026, për konsultim paraprak në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në vijim të këtij komunikimin, disa nga bashkitë kanë dërguar dakordësinë dhe/ ose komente, të cilat janë marrë në konsideratë për aq sa është e mundshme. Për sugjerimet që nuk janë marrë në konsideratë janë dhënë argumentimet përkatëse. Konkretisht:

Bashkia Berat u shpreh konform projektvendimit, pa komente apo sugjerime. Ndërkohë, Bashkia Tiranë, Bashkia Krujë, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Dropull u shpreh me sugjerime të përgjithshme, ku një pjesë e tyre janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të draft vendimit.

Për sugjerimin lidhur me afatin e raportimit nga operatorët, sqarojmë se është marrë në konsideratë dhe është përcaktuar raportimi brenda datës 15 shkurt të çdo viti.

Komentet që lidhen me mungesën e kapaciteteve dhe mekanizmave financiare, nuk u morën në konsideratë, pasi nuk janë objekt i ndërhyrjeve në këtë projektvendim.

Lidhur me sugjerimet për standardizimin e ngjyrave, formës së kontejnerëve, frekuenca minimale e pastrimit, dezinfektimit dhe përdorimi i kontejnerëve me sensorë, sqarojmë se këto kritere dhe procedura përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore duke marrë në konsideratë rrymën mbetjeve, densitetin e popullsisë dhe kushtet teknike e infrastrukturore të zonës.

Lidhur me komentimin mbi parashikimin e një formati standard për raportimin periodik, sqarojmë se nuk janë objekt i ndërhyrjeve në këtë projektvendim.

Për sugjerimin lidhur me parashikimin e fazave ose objektivave ndërmjetëse për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sqarojmë se nuk janë objekt i ndërhyrjeve në këtë projektvendim dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore i parashikojnë këto faza të ndërmjetme në planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Projektvendimi është publikuar edhe në faqen e konsultimit publik.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me atë të Vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk parashikon të sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Sofjan JAUPAJ

